



SI TA MBAJMË HAPËSIRËN QYTETARE TË SHËNDETSHMË: SHPËTIMI I JETËVE DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT



European Center for
Not-for-Profit Law

ICNL
INTERNATIONAL CENTER
FOR NOT-FOR-PROFIT LAW

Përgjigja ndaj Covid-19 është aktualisht një përpjekje gjithëpërfshirëse për qeveritë dhe popujt në të gjitha vendet e botës. Në këtë kohë urgjence, Qendra ndërkombëtare dhe ajo europiane për të drejtën jo-për-përfitim (ICNL dhe ECNL) ofrojnë këtë udhëzues të shkurtër për autoritetet që përpiqen të mbrojnë jetët paralelisht me detyrën e tyre për të ruajtur të drejtat e njeriut dhe për të mbrojtur dinjitetin e njeriut, bazuar në detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ky dokument i shkurtër është pjesë e një nisme më të gjerë të ECNL/ICNL për të mbështetur qasjet e bazuara në të drejtat e njeriut për të tejkaluar pandeminë Covid-19 ndërsa njëkohësisht duke mbrojtur liritë tona të asociimit, tubimit, shprehjes dhe pjesëmarrjes.

ÇFARË DUHET TË BËJNË SHTETET

1. **Të përcaktojnë shpejtë natyrën e saktë të kërcënimit.** Përderisa Covid-19 është një sfidë, jo të gjitha aspektet e sfidës kërkojnë një reagim emergjent. Kur shpallin emergjencë të Covid-19, shtetet duhet të artikulojnë qartë kërcënimet specifike - si në fushëveprim ashtu edhe për nga natyra - të cilat emergjenca synon t'i adresojë.

Të përkufizojnë ngushtë dhe të sigurojnë që të gjitha kufizimet e të drejtave dhe lirive janë të nevojshme dhe proporcionale. Masat e përgjigjes ndaj Covid-19 duhet të hartohen në atë mënyrë që të minimizojnë kufizimet e drejtave dhe lirive. Kur kufizime të tilla janë të domosdoshme, kërkesa themelore është që të gjitha masat e tilla të kufizohen në masën që kërkohet në mënyrë strikte nga kërkesa urgjente e situatës dhe e nevojshme për t'iu përgjigjur një rreziku aktual, të qartë, prezent ose të pashmangshëm.

Të shpallin publikisht gjendjen e emergjencës ose çfarëdo masë që kufizon të drejtat dhe liritë. Shpallja duhet të bëhet nga një burim i qartë dhe i qasshëm dhe të jetë në dispozicion dhe e kuptueshme për publikun në përgjithësi. Të gjithë njerëzit në shoqëri duhet të jenë në gjendje të kuptojnë masat, arsyet e miratimit të tyre dhe të jenë në gjendje t'i përmbahen ose t'i kundërshtojnë vendimet dhe veprimet e Shtetit.

Të miratojnë masa afatshkurtra me mundësi rishikimi. Gjendjet dhe masat e zgjatura të emergjencës lidhen me shpeshtësinë më të lartë të shkeljes së të drejtave të njeriut. Sa më gjatë ose më shumë të thellohet gjendja, më e ngushtë është margjina e respektimit që i është ceduar Shtetit. Shtetet duhet, kurdo të jetë e mundur, të miratojnë masa afatshkurtra, të ripërtëritshme dhe të përfshijnë klauzola automatike të shfuqizimit.

Të respektojnë gjithnjë parimet e ligjshmërisë dhe sundimin e ligjit. Kërkesat themelore të gjyqimit të drejtë, prezumimit të pafajësisë dhe procesit të mirëfilltë duhet të mbeten dhe të respektohen gjatë gjendjes së emergjencës për të gjithë njerëzit. Futja e veprave të reja penale ose zbatimi përmes ndjekjes penale duhet të përdoren vetëm si mjet i fundit.

Të derogojnë zyrtarisht nga detyrimet e traktateve për të drejtat e njeriut. Kur kufizon të drejtat dhe liritë e njeriut, një Shtet duhet të dërgoj njoftime zyrtare për derogim tek organet përkatëse të traktatit për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie të veprimeve përpara organizatave ndërkombëtare.

"COVID-19 është një test për shoqëritë tona dhe të gjithë jemi duke u mësuar dhe përshtatur ndërsa reagojmë ndaj virusit. Dinjiteti dhe të drejtat e njeriut duhet të jenë të parat dhe qendrore në këto përpjekje, e jo një konsideratë e mëvonshme. Mbylljet, karantinat dhe masa të tjera të ngjashme për të frenuar dhe luftuar përhapjen e COVID-19 gjithmonë duhet të zbatohen strikt në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe në një mënyrë të nevojshme dhe proporcionale me rrezikun e vlerësuar - por edhe kur vlerësohen si të tilla, ato mund të kenë pasoja serioze në jetën e njerëzve."

**Komisioneri i lartë i OKB-së
për të drejtat e njeriut**

ÇFARË NUK DUHET TË BËJNË SHTETET

Mbrojtja e të drejtave të njeriut brenda Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit kërkon që Shtetet të zbatojnë Rregulloret me respekt të plotë për dinjitetin, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të personave, dhe të ushtrojnë autorizimet e tyre shëndetësore në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese. Organizata Botërore e Shëndetësisë deklaron që parimet thelbësore të të drejtave të njeriut dhe të shëndetit përfshijnë **llogaridhënien, barazinë, mosdiskriminimin dhe pjesëmarrjen**. Pjesëmarrja domethënëse, si një tipar i qasjes bazuar në të drejta, do të thotë të siguruarit që hisedarët kombëtarë - përfshirë aktorët jo-shtetërorë, siç janë organizatat joqeveritare - të jenë përfshirë në mënyrë kuptimplote në të gjitha fazat e programimit: vlerësimin, analizën, planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin. Pjesëmarrja është e rëndësishme për llogaridhënien pasi siguron kontrollin dhe balancën të cilat nuk i lejojnë udhëheqjes unitare të ushtrojë pushtetin në mënyrë arbitrare.

Parimet e drejtave të njeriut sipas OBSH-së

- 1. Mos përdorni masa emergjente për të targetuar grupe të veçanta - siç janë migrantët ose refugjatët, organizatat e shoqërisë civile ose mbrojtësit e drejtave të njeriut.** Shtetet duhet të sigurojnë që masat e ndërmarra nuk kanë ndikim negativ në pakicat dhe grupet e cenueshme (përfshirë gra dhe fëmijë) ose grupe fetare, etnike ose të identifikuar sociale në mënyra selektive ose diskriminuese. Masat e tilla nuk duhet të targetojnë një grup të veçantë të organizatave të shoqërisë civile ose mbrojtësit e të drejtave të njeriut.
- 2. Mos miratoni masa të tepërta ose represive që do të shtypnin kundërshtimin.** Të gjitha masat duhet të jenë të nevojshme në mënyrë strikte nga nevojat e veçanta urgjente që rrjedhin nga pandemia dhe të ju përgjigjen proporcionalisht atyre nevojave.
- 3. Mos kufizoni të drejtat e bazuara në traktate që nuk mund të kufizohen ose pezullohen.** Pavarësisht nga shtrirja ose burimi i krizës, detyrimet e mëposhtme sipas traktateve shtetërore nuk mund të derogohen as në gjendje të jashtëzakonshme: e drejta për jetë, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit, liria nga tortura, trajtimi çnjerëzor dhe degradues, skllavëria dhe robëria, burgimi për shkak të pamundësisë për të përmbushur detyrimet kontraktuale dhe zbatimi i ligjeve ex post facto.
- 4. Mos kufizoni të drejtat e përcaktuara qartë si absolute sipas të drejtës ndërkombëtare.** Komiteti për të Drejtat e Njeriut i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së) thotë se disa kufizime në sjelljen e Shtetit janë absolute edhe në kohë të rasteve emergjente, siç janë detyrimi i të drejtës humanitare dhe ndalimi i marrjes së pengjeve, vendosja e dënimeve kolektive, privimi arbitrar i lirisë dhe devijimi nga parimet themelore të gjykimit të drejtë, përfshi prezumimin e pafajësisë.
- 5. Mos hartoni dhe miratoni masa afatgjata.** Çfarëdo mase emergjente e ndërmarrë duhet të jetë sa më pak ndërhyrëse për të arritur objektivin e tyre, përfshirë edhe kohëzgjatjen. Kur kohëzgjatja e rrethanave urgjente është e panjohur, masat duhet të jenë afatshkurtra me mundësinë e rinovimit.
- 6. Mos kufizoni mjetet juridike për shkelje të të drejtave dhe lirive.** Edhe nëse një Shtet vendos përshtatje në funksionimin e procedurave të veta gjatë emergjencës, duhet të sigurojë një mjet juridik efektiv për shkeljet e drejtave dhe lirive, siç është qasja në procedurë gjyqësore.

Burimet dhe baza ligjore:

Pakti Ndërkombëtar i OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 4;
Komenti i përgjithshëm nr. 29 i Komitetit të Drejtave të Njeriut të OKB-së;
Raportuesi Special i OKB-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore gjatë luftës kundër terrorizmit, Sfida për të drejtat e njeriut në gjendje të jashtëzakonshme në kontekstin e luftës kundër terrorizmit, A/HRC/37/52;
Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit 2005. Ed. 2. Organizata Botërore e Shëndetësisë; 2008.



Ky raport financohet pjesërisht nga Qeveria e Suedisë. Qeveria e Suedisë nuk ndanë domosdo mendimet e shprehura këtu. Vetëm autori mban përgjegjësinë për përmbajtjen.

Përmbajtja origjinale e këtij dokumenti është në gjuhën angleze, e hartuar nga ICNL dhe ECNL. KCSF ka përkthyer dhe përshtatur këtë dokument në gjuhën shqipe, por nuk mban asnjë të drejtë autoriale. KCSF përkrahet nga Suedia.